



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi a) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Grandelite" Sh.P.K. të datës 29.01.2024 kundër njoftimit për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i urave në pjesën perëndimore të unazës qendrore" me nr. të prokurimit 616-23-14005-5-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **HEDHET POSHTË si e palejuar** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Grandelite" Sh.P.K. e datës 29.01.2024 kundër njoftimit për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i urave në pjesën perëndimore të unazës qendrore" me nr. të prokurimit 616-23-14005-5-1-1.
- II. **LEJOHET** autoriteti kontraktues të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik "Grandelite" Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Grandelite" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 29.01.2024 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i urave në pjesën perëndimore të unazës qendrore" me nr. të prokurimit 616-23-14005-5-1-1. Hapja e ofertave për këtë aktivitet të prokurimit është përcaktuar me datë 30.01.2024. Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa për rishqyrtim është e palejuar pasi që të parashtruar pas afatit të përcaktuar me nenin 60 paragrafin 60.1 nënparagrafin a) të RRPP. Po ashtu kërkesa për rishqyrtim nuk i përmban të gjitha të dhënat e nevojshme sipas formularit F02 prandaj si e tillë është parashtruar në kundërshtim me nenin 60 paragrafin 60.1. dhe 60.3 lidhur me nenin 62 paragrafin 62.1 nënparagrafin a) të RRPP.

Përmes nenit 60 paragrafin 60.1 nënparagrafin a) të RRPP është përcaktuar se “Kurdo që kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit se paku pesë (5) ditë para afatit të fundit për dorëzim të ofertave. Në kalkulim të afateve kohore dita e dorëzimit të ofertave është dita (0)”. Në rastin konkret dita zero (0) llogaritet data 30.01.2024 kur edhe do të bëhet hapja e tenderëve. Rrjedhimisht data e fundit për të parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë është pesë (5) ditë më herët respektivisht data 24.01.2024 në ora 16:00. Në anën tjetër kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është dorëzuar me datë 29.01.2024 në ora 23:03, pra jashtë afatit ligjor.

Përmes nenit 60 paragrafit 60.1 të RRPP është përcaktuar se “Kërkesa për rishqyrtim duhet të përmbajë të dhënat në pajtim me formularin F02”. Tutje përmes paragrafit 60.3 është përcaktuar se “Kërkesa për rishqyrtim duhet të përmbajë: a. emrin, adresën postare, adresën elektronike, dhe informatat e kontaktit të parashtruesit të ankesës”. Në anën tjetër në pjesën e parë të kërkesës për rishqyrtim me titull “Identifikimi i operatorit ekonomik” nuk është evidentuar asnjë nga të dhënat e kërkuara sipas dispozitës së cituar më sipër.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se kërkesa për rishqyrtim është paraqitur pas afatit të përcaktuar me nenin 60 paragrafin 60.1 paragrafin a) të RRPP dhe njëkohësisht nuk është parashtruar në përputhje me nenin 60 paragrafin 60.1. dhe 60.3 lidhur me nenin 62 paragrafin 62.1 nënparagrafin a) të RRPP. Si e tillë kërkesa për rishqyrtim duhet të hedhet poshtë si e palejuar përkatësisht si e pasafatshme në kuptim të nenit 62.1. paragrafit a) lidhur me nenin 63 paragrafit 63.1 nënparagrafit 63.1.1 pikës b) të RRPP.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1 nënparagrafin 63.1.1 pikën b) lidhur me nenin 62 paragrafin 62.1 nënparagrafin b) si dhe nenin 60 paragrafin 60.1. nënparagrafin a) të RRPP. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 30.01.2024



Visar SHEHU
Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.